

SiCRED SH.A., SHOQËRIA E SIGURIMIT TË JETËS MË E SOFISTIKUAR DHE E DIVERSIFIKUAR NË TREGUN E SIGURIMEVE NË SHQIPËRI



E ardhmja është e pasigurt. Ngjarjet e gjashtë muajve të fundit, tërmeti në Nëntor 2019 dhe pandemia e COVID-19, kanë bërë që çdokush të reflektojë më gjatë për rreziqet me të cilat mund të ndeshemi papritur çdo ditë. Shtëpia, pasuria, financa, madje edhe shëndeti jonë, mund të ndryshojnë tërësisht brenda ditës, orës, sekondave. Aty ku ka pasiguri për të ardhmen, aty ku faktorë të ndryshëm veprojnë në jetët tona, duke na vënë në rrezik çdo gjë që kemi e jemi, ekzistojnë kompani, produkte dhe persona, të cilët i kanë paraprakisht përgjigjet e pyetjeve "Po nëse...?". Shoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a., u themelua në vitin 2003, nën vizionin për të qenë e para shoqëri sigurimi jete private në Shqipëri. Që në muajt e parë të krijimit të saj, SiCRED prezantoi për tregun vendas një gamë të gjerë me produkte sigurimi jete, kombinuar me përfitime shtesë për shëndetin, aksidentet dhe sëmundjet kritike, si dhe krijoi bashkëpunim të ngushtë me disa prej institucioneve më të mëdha financiare, që përgjatë viteve do të ktheheshin në partnerët e saj kryesorë.

PAS 15 VITEVE AKTIVITET, SiCRED GËZON

GAMË TË GJERË PRODUKTESH

Shoqëria aktualisht ka 12 produkte të licencuara pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të cilat mbulojnë nevojat për sigurim për individë, familje, institucione private dhe publike. Policat e sigurimit të SiCRED janë dizenuar me kujdes nga ekupe profesionistësh, për të qenë të kuptueshme, transparente si dhe duke qenë të drejtë me klientin në raportin përfitime-prime.

KLIENTË BESNIKË

Rreth 22,000 klientë në të gjithë Shqipërinë, të cilët kanë zgjedhur policat e SiCRED për sigurimin e jetës, shëndetit, aksidenteve, etj. Për vetë natyrën afatgjatë që ka sigurimi i jetës, pjesa më e madhe janë prej disa vitesh klientë të SiCRED, duke e shtuar çdo ditë e më shumë përgjegjësinë tonë për t'u ofruar atyre më të mirën, përmes këshillimit profesional si dhe ofrimit të një sërë zgjidhjesh.

EKSPERIENCË DHE PROFESIONISTË TË KUALIFIKUAR

Aktualisht SiCRED ka 50 punonjës, të zgjedhur me kujdes sipas profilit të punës. Formimi, eksperiencia disavejçare në

sigurimin e jetës dhe jo-jetës si dhe përkushtimi i tyre, janë energjia që sjellin ndryshim dhe transformojnë jetë.

TEKNOLOGJI TË AVANCUAR

Një nga planet më ambicioze të SiCRED ka qenë implementimi i sistemit të integruar, një strukturë teknologjike, e aftë të mbështesë të gjitha njësitet operative në SiCRED, duke përfshirë marketingun, shitjet, financën, administrimin etj. Sistemi i integruar dhe modulet të tij janë ndërtuar rreth klientit, duke mundësuar krijimin dhe ruajtjen e historikut të tij në SiCRED. Falë kësaj teknologjie, ndërsa klienti kalon në faza të ndryshme të jetës së tij, SiCRED e njeh më mirë atë dhe është e aftë të japë zgjidhje dhe të plotësojë nevojat për sigurim të klientit, që në momentin që këto nevoja lindin. Sektori i sigurimit është ndër sektorët që përpunojnë sasi më të mëdha dhe të shumëllojshëm informacioni. Për këtë arsye, në pajtueshmëri me udhëzimet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e informacionit, shoqëria ka investuar tërësisht në një ambient të ri duke e kthyer në Arkivë Qendrore, të shkëputur nga zyrat qendrore, për të ofruar konfidencialitetin dhe sigurinë maksimale në mbledhjen, përpunimin transmetimit dhe ruajtjen e të dhënave.

RRJET TË GJERË MJEKËSOR

Të siguruarit e SiCRED përfitojnë shërbimet dhe çmimet preferenciale në mbi 110 spitale dhe klinika, pjesë të rrjetit mjekësor SiCRED. Partnerët mjekësorë shtrihen në të gjithë Shqipërinë, si dhe në Kosovë, Greqi, Itali, Austri dhe Turqi. Së shpejti një rrjet i ri spitalor në Turqi si dhe dy spitale në Lombardi, Itali, të specializuar në pediatri, do t'i bashkohen rrjetit mjekësor të SiCRED. Shoqëria kujdeset që pjesë e bashkëpunimit të jenë spitale dhe klinika, të cilat për të ofruar kujdes mjekësor, plotësojnë të gjitha kushtet dhe standardet e kërkuara nga organet kompetente.

VENDNDODHJE STRATEGJIKE

SiCRED ka degë në qytetet më të mëdha në Shqipëri, ku janë qendrat kryesore të jetës ekonomike dhe sociale në vend. Përveç kësaj, degë ka edhe në qytete më të vogla të vendit, me qëllim për të qenë lehtësisht i arritshëm nga çdo banor i Shqipërisë, në çdo cep të saj.

BASHKËPUNIMI ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË TË BESUAR DHE ME EKSPERIENCË TË NJOHUR

Profili i SiCRED ka tërhequr vëmendjen e disa prej shoqërive kryesore të risigurimit në Europë dhe botë. Që nga 2005 SiCRED bashkëpunon me APRIL International E.M.E.A. (CORIS), një ndër kompanitë e asistencës më të mëdha në botë, për asistencë në zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim. Prej 13 vjetësh SiCRED bashkëpunon me SCOR Global Life, një prej 5 risiguresve më të mëdhenj në botë. Eksperiencia e fituar nga ky bashkëpunim si dhe trajnimet e shumta të ofruar nga SCOR, tashmë janë pasuri jo vetëm e SiCRED, por e të gjithë tregut shqiptar të sigurimeve. Prej 3 vjetësh, SiCRED bashkëpunon me një ndër brokerat kryesorë të tregjeve të Londrës, Guy Carpenter, për risigurimin e risqeve të mëdha, ku risigures kryesor ka qenë QBE Re, një ndër 20 siguresit dhe risiguresit më të mëdhenj në botë. Bashkëpunimi ndërmjet SiCRED dhe QBE është shtrirë edhe më tej. QBE është partneri i SiCRED për zhvillimin e produkteve të sigurimit, të fokusuar te mikrofinanca, ose, e thënë ndryshe, produkte mikrosigurimi. Këto produkte karakterizohen nga afat i shkurtër sigurimi dhe procedura të lehtësuara të marrjes në sigurim, duke u përshtatur me profilin e produkteve mikrofinanciare dhe karakteristikat e tyre.

DIVERSIFIKIM PORTOFOLI:

INVESTIM NË FONDE PENSIONI DHE INVESTIMI

Në SiCRED ofrohen një sërë mundësish për një investitor, i cili dëshiron të diversifikojë portofolin e tij të investimeve. Dilema e pensioneve ka qenë dhe vijon të jetë një ndër temat e nxehta të ekonomisë shqiptare. Sipas të gjithë parashikimeve, skema shtetërore e pensionit është e pamjaftueshme për të garantuar një jetesë minimale në moshën e pensionit. E ndaj shprehja "I vetmi person, që do të kujdeset për ty kur të jesh plakur, është i riu që je ti sot", përmban një nxitje për veprim. Duke parë mundësitë që ofronte tregu, si dhe me synimin për të diversifikuar portofolin e produkteve financiare me horizont të gjatë investimi, SiCRED vendosi të zgjeronte aktivitetin duke u shtrirë në fushën e pensioneve private, nëpërmjet blerjes së 75% të kuotave dhe rilicencimit në 2011 të SiCRED sh.a. – Shoqëria e Administrimit të Fondit të Pensionit (sot CREDINS Invest). Fondi i Pensionit i administruar nga SiCRED tërhoqi vëmendjen e një prej bankave më të mëdha në vend, e cila përmes marrëveshjes së shitblerjes të vitit 2017, sot zotëron aksionet mazhoritare në Shoqërinë Administruese. SiCRED vijon të ketë një pjesëmarrje strategjike prej 12%, e ndërkaq punonjës të specializuar të SiCRED janë të autorizuar për promovimin dhe shitjen e kuotave në dy fondet: Fondi i Pensionit Privat "CREDINS Pension" dhe Fondi i Investimit "CREDINS Premium".

SiCRED ASSISTANCE: SHËRBIME TË SPECIALIZUARA KONSULENCE DHE NDËRMJETËSIMI

Nën optikën e ndryshimit të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, SiCRED krijoi shoqërinë SiCRED Assistance sh.p.k, një shoqëri që ofron konsulencë të plotë dhe shërbime të specializuara për sigurinë dhe shëndetin në

punë. Kombinimi i sigurimit jetë-aksidente-shëndet me shërbimet e specializuara për sigurinë dhe shëndetin në punë, është një paketë shërbimesh premium që dizenuar për të plotësuar kërkesat dhe nevojat për miradministrimin dhe sigurinë e burimeve njerëzore, specifkisht për çdo institucion privat apo shtetëror.

SiCRED Assistance ka zgjeruar më tej aktivitetin duke ofruar ndërmjetësim në punësimin e të huajve në Shqipëri si dhe ndërmjetësim në shërbime mjekësore. Ndërmjetësimi në shërbime mjekësore, i ofron mundësinë një klienti, kur ai nuk është i pajisur me një policë sigurimi shëndeti dhe ka nevojë të marrë shërbime mjekësore, që të gjendet dhe t'i sugjerohet në kohën më të shkurtër të mundshme trajtimi mjekësor i përshtatshëm, përmes partnerëve spitalorë të SiCRED Assistance jashtë Shqipërisë.

SiCRED PIKË REFERENCE PËR KLIENTIN ME SHËRBIME NË 360°

Koha është e çmuar dhe jeta është e vru-lshme. Çdo ditë na duhet të bëjmë më shumë gjëra dhe në më pak kohë se një ditë më parë. Vizioni i SiCRED është të kthehet në një pikë reference për klientin, për çdo nevojë të tij për sigurim, investim dhe veprime financiare. Në përputhje me këtë vizion, shoqëria planifikon të shtrihet në fusha të tjera si transfertat, operacione financiare dhe mikrofinancë, të cilat do t'i mundësojnë klientit shërbim 360° në konceptin one-stop-shop.

ANGAZHIM NË FUSHËN E DISTRIBUCIONIT

Përgjatë viteve, SiCRED ka qenë iniciatore dhe mbështetëse e ideve novatore. Një nga projektet e ardhshme të SiCRED është angazhimi në fushën e distribucionit. Duke u mbështetur në një eksperiencë të gjatë dhe profesionale, fokusi i kësaj kompanie do të jetë i përqendruar kryesisht në biznesin e-Commerce. Me vizion për të ngritur një rrjet të sigurt e të besueshëm shpërndarjeje në tregjet vendase dhe të huaja; partneritet me komunitetin, biznesin, institucionet dhe organizatat, kjo shoqëri do jetë e fokusuar në krijimin e vlerave ekonomike dhe sociale.

SHËRBIME TË SPECIALIZUARA NË FUSHËN INBOUND MARKETING

Zhvillimet teknologjike të shekullit të fundit kanë sjellë ndryshime radikale në mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe komunikojmë. Çdo person merr dhe përpunon çdo ditë informacione të pafundme përmes aparateve celulare, tablet, PC, TV etj. Në morinë e këtij informacioni, mesazhi i nisur nga një kompani humbet dhe shuhet gjatë rrugës pa arritur te audienca e saj, nëse nuk aplikohet një përqasje e kujdesshme. Eksperiencia e fituar në menaxhimin e marrëdhënies me klientët, përmes aplikimit të teknikave të reja, e kanë bërë SiCRED besimplotë për ta ndarë këtë përvojë me tregun shqiptar. Gama e produkteve, që mbajnë firmën SiCRED, do të plotësohet më tej me ofrimin e shërbimeve të specializuara në fushën e marketingut Inbound, të cilat parashikohet t'i ofrohen klientëve vendas brenda një periudhe 3 vjeçare.